



TEATRI I OPERËS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR

LIBRETI MUJOR – PRILL 2023



224 ARTISTË NË SKENËN E TKOB-SË PËR "CARMINA BURANA"

"Carmina Burana", një vepër e fuqishme muzikore, mbledhi 224 artistë në një natë simfonike për 780 artdashës, nisur me një ndjenjë po aq të fuqishme si "O fortuna", duke u ndalur qetësisht me "In Trutina". Reflektimi i ndjenjës së dashurisë dhe vuajtjes njerëzore, erdhi lavdishëm nga bashkëpunimi mes trupës artistike të Orkestrës Simfonike të Korit të TKOB-së, Filharmonisë së Kosovës, Orkestrës Simfonike të Forcave të Armatosura, Konservatorin Shtetëror të Salernos "Giuseppe Martucci" dhe Kori i Zërave të Bardhë TKOB.

"AKADEMIA TEATRALE" RISI NË TKOB

Teatri i Operës dhe Baletit organizoi programin e parë profesional muzikor në Shqipëri "Akademia Teatrale", që kontribuon në mjeshtërinë artistike të talenteve të artit klasik.

Me mbështetjen dhe eksperiencën e sopranos ikonike me famë ndërkombëtare, Ermonela Jaho, e cila u rikthye në atdhe me titullin "Artistja e Vitit", akorduar nga "Çmimet Ndërkombëtare të Muzikës Klasike 2023", për të kontribuar me një masterclass, nga data 14-18 prill.



Një projekt i ndërtuar mbi bazën e përvojave më të suksesshme ndërkombëtare, ofroi shumëçka rreth interpretimit skenik, teknikës vokale, përgatitjes psikologjike për trajtimin e rolit si dhe disa tematika të veçanta e interesante për pjesëmarrësit.



Teatri Kombëtar i Operës,
Baletit dhe Ansamblit Popullor



Teatri i Operës dhe Baletit

BALETI "GISELLE" U TEJÇUA TE PUBLIKU ME SILUETA TË JASHTËZAKONSHME

Erdhi në Teatrin e Përjetimeve, nëpërmjet lëvizjeve të bukura skenike të Trupës së Baletit dhe Solistëve të TKOB-së, baleti "Giselle" i Adolphe Adam, nën koreografinë e Giuseppe Picone-s, një nga yjet më të shquar të baletit në Evropë, dhe profesionalizmit të dirigjentes së Trupës, Alisa Gjoni. Historia e "Giselle", një vajzë 15-vjeçare, e cila pavarësisht që zhgënjehet nga dashuria e saj e parë, vijon të përjetojë të njëjtin emocion edhe në botën e përtejme. Por lufta e vilizave do t'ia bëjë më të vështirë këtë dashuri!



BASHKËPUNIMI 4-PALËSH SJELL "QUATTRO PEZZI SACRI" NË TKOB

Të shenjta ishin "4 pjesët e Verdit", i shenjtë ishte bashkëpunimi 4-palësh ndërinstitucional dhe e shenjtë ishte mbrëmja e 8 prillit!

Koncerti simfonik koral "Quattro pezzi sacri" vulosi madhështinë e G. Verdit në TKOB, me himnin mëshirues "Stabat Mater dolorosa", dedikuar vuajtjeve dhe sakrificave të Zojës së Shenjtë Mari, që përkthehet përmes fjalëve të dhembshura "nëna e pikëlluar qëndron në këmbë".

Madhështia e "Quattro pezzi sacri" rrëmbeu shumë duartrokitje të zjarra, me ndërveprimin e frytshëm mes Orkestrës Simfonike dhe Korit të TKOB-së, pjesëmarrjes së veçantë të Korit të Filharmonisë së Kosovës, potencialit rinor të Orkestrës Simfonike të Forcave të Armatosura dhe Konservatorit Shtetëror të Salernos.



**ANSAMBLI POPULLOR
VURI NË SKENË
KONCERTIN RECITAL**



Më 15 prill, valle për violine, kaba për klarinetë, orkestrale për çifteli e orkestrale për bilbil, e shumë të tjera pat vetëm në TKOB! Me koncertin recital "Këndojmë me Orkestrën e Ansambilit", ideuar nga Alban Tahiri, Orkestra e Ansambilit Popullor, nën dirigjimin e Vladimir Hasimit, u sollën për publikun veprat më të bukura nga të gjitha trevat shqiptare. Publiku traditëdashës e ka dëshmuar prej kohësh se kur këndon Orkestra e Ansambilit është gjithmonë gati për ta ndjekur



FINALIZOHET ME SUKSES MAGJIA E "SAMSON ET DALILA"

Opera "Samson et Dalila", një vepër e kompozitorit Camille Saint-Saëns, me libret të Ferdinand Lemaire, shkruar në fillimet e luftës franko-prusiane, e cila erdhi si PREMIERË në TKOB, u luajt për 3 ditë radhazi në TKOB!

Dalila, priftëresha e perëndisë Dagon, joshi me bukurinë e saj, Samson-en, udhëheqësin e hebrenjve, për të zbuluar sekretin e forcës së tij e për ta shkatërruar plotësisht atë. Kjo vepër trajton episodin e njohur biblik të konfliktit midis hebrenjve, udhëhequr nga Samsoni i guximshëm, dhe filistinëve paganë e shtypës.

Nën idetë regjisoriale të Paul - Émile Fourny, drejtorit të Përgjithshëm të Opéra-Théâtre - Eurometropole de Metz, nën notat unike të mezzo-sopranos Vikena Kamenica, e cila solli hijeshinë e Dalilës, tenorit Dario Di Vietri që erdhi me rolin e udhëheqësit të guximshëm, Samson, dhe baritonit Armando Likaj, i veshur me rolin e Priftit të Perëndisë së Dagonit, shoqëruar nga Orkestra Simfonike dhe Kori i TKOB-së, me pjesëmarrjen edhe të Konservatorit të Salernos "Giuseppe Martucci".



Nën idetë regjisoriale të Paul - Émile Fourny, drejtorit të Përgjithshëm të Opéra-Théâtre - Eurometropole de Metz, nën notat unike të mezzo-sopranos Vikena Kamenica, e cila solli hijeshinë e Dalilës, tenorit Dario Di Vietri që erdhi me rolin e udhëheqësit të guximshëm, Samson, dhe baritonit Armando Likaj, i veshur me rolin e Priftit të Perëndisë së Dagonit, shoqëruar nga Orkestra Simfonike dhe Kori i TKOB-së, me pjesëmarrjen edhe të Konservatorit të Salernos "Giuseppe Martucci".

VIJON PROGRAMI "OPERA PËR FËMIJË E FAMILJE", ME "LA TRAVIATA"

Një tjetër histori dashurie, mes një kurtizaneje të re, të njohur në shoqërinë e lartë parisienne, Violetta Valéry, dhe një fisniku të pasur të quajtur Alfredo Germont u shfaq për 2 dite radhazi në TKOB. Pavarësisht dashurisë së tyre të pamohueshme për njëri-tjetrin, presionet shoqërore kërcënojnë të ndajnë çiftin, duke i çuar ato drejt një fundi dramatik.

"La traviata", me pot emocione, i afron fëmijët më tepër me kulturën operistike, duke i mbajtur të përqafuar me artin si një formë rritjeje, shërimi dhe ndërgjegjësimi.

Nën regjinë e Ada Gurrës, profesionalizmin e koncertmaester Etrita Ibrahim, me pjesëmarrjen e Sopranove Nina Muho dhe Simona Karafili Demo në rolin e Violetta, Tenorit Denis Skura në rolin e Alfredo, Baritonit Ylber Gjini në rolin e babait të Violettes dhe me mbështetjen e kuartetit të Harqeve të TKOB-së